



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 15.1.2025

Nr: 2

Ora: 11:05

VENDIMI

PËR

**MOSPANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 18, DATË 24.10.2024
TË DEPOZITUAR NGA QENDRA VENDORE AUDIOVIZIVE SHKODËR**

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.1.2025, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi kryesisht çështjen me:

ANKUES: Qendra Vendore Audiovizive Shkodër

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”

BAZË LIGJORE: Nenet 12/5, 7, neni 21, pika 1 shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 15.1.2025 Nr: 2
Ora: 11:05



“Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 18 datë 24.10.2024 të depozituar nga Qendra Vendore Audiovizive Shkodër”

VËREN:

1. Subjekti Qendra Vendore Audiovizive Shkodër depozitoi pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, u regjistrua në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 18 regj., datë 24.10.2024.
2. Në mbledhjen e datës 15.1.2025, pas relativitetit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 18, nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “b”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore nuk duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

VENDOSI:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 18, datë 24.10.2024 të depozituar nga subjekti Qendra Vendore Audiovizive Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1, të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

U shpall sot, më datë 15.1.2025.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar